



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

Nr. 1429/1 prot.

Tiranë më 01.09.2023

Lënda: Mbi dorëzimin e formateve të PBA 2024-2026

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, përçjell kërkesat buxhetore përmes formateve standarde tabelarë, shoqëruar me relacionin shpjegues bashkëlidhur

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Koncepto  L. Morina



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

RELACION

MBI

PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026

FAZA TEKNIKE

Në zbatim të VKM nr.436, datë 19.07.2023 "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 28.02.2019 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 07.07.2023 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026*", Grupi i Menaxhimit Strategjik në Institucionin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka punuar për rishikimin e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, Faza teknike (Faza e dytë).

Në prill të vitit 2023, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 05.04.2023, "*Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026*", si dhe akteve administrative për përgatitjen e PBA 2024-2026, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*këtu e në vijim Zyra e Komisionerit ose KDIMDP*), ka përgatitur dhe finalizuar kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm (projekt buxhetin) për vitet 2024-2026 (Faza Strategjike).

Në funksion të zbatimit të ligjeve, fushë e përgjegjësisë, si dhe për realizimin e detyrave dhe kompetencave gjithnjë në rritje të Zyrës së Komisionerit, është hartuar dhe programuar rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, e cila ka lindur si domosdoshmëri për tu plotësuar, me qëllim realizimin e misionit tonë në kohë reale dhe dinamike. Misioni ynë mbetet dhënia e garancisë mbi aksesin dhe njohjen e qytetarëve me informacionin publik si dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e në veçanti të drejtën për informim dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vizioni ynë është harmonizimi i bashkëpunimit dhe veprimtarisë me autoritetet publike dhe me kontrolluesit publik/privat për forcimin e mjedisit në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.

Kjo materializohet nëpërmjet qëllimit të programit i cili është:

1-nxijtja e përputhshmërisë së sektorit publik dhe privat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit,

2-vendosja e balancës midis dy të drejtave të shtetasve, duke ofruar ekspertizën për ligjbërësit kombëtarë, me qëllim adoptimin e standardeve evropiane në të dyja fushat.

3-Realizimin e mbikëqyrjeve/inspektimeve për zbatimin e detyrimeve ligjore, vendosjen e sanksioneve administrative në rastet flagrante të shkeljes së detyrimeve, shqyrtimin e ankesave në lidhje me të drejtën për akses në informacionin publik apo cënimin e privatësisë, në bazë të të cilave Komisioneri ushtron vendimmarrjen e tij.

4-Menaxhimin me efektivitet dhe korrektësi i fondeve buxhetore të KDIMDP-së.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2023 dhe në vijim objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- Pasja e rolit aktiv në përmbylljen e procedurave për miratimin e kuadrit ligjor/nënligjor për të dy fushat e veprimtarisë;
- bashkëpunimi në mënyrë të vazhdueshme me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor në të dyja fushat e përgjegjësisë si dhe nxitjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e tij;
- thellimi i mbikëqyrjes dhe monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke patur si qëllim rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike si dhe garantimin e aksesit në informacion publik;
- verifikimin dhe mbikëqyrjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike, mbi zbatimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- shtrirja e instalimit të REKPDI në sa më shumë autoritete publike, si dhe të mundësimi i ndërthurjes së tij me shërbimet që ofrohen nga AMS/e-Albania, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- shtimi i burimeve njerëzore dhe financiare për forcimin e kapaciteteve administrative në kuadër të harmonizimit integral të legjislacionit në të dy fushat e përgjegjësisë;
- përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit me fokus të veçantë, thellimin e njohurive në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), si detyrime specifike që burojnë nga legjislacioni i përmirësuar;
- komunikimi proaktiv me autoritetet publike për konsolidimin e kulturës së transparencës, forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim dhe trajnimi periodik i koordinatorëve për të drejtën e informimit veçanërisht për trajtimin e çështjeve me interes publik në balancë me kufizimet për dhënien e informacionit;
- nxitja e qasjes së re të kontrolluesve/përpunuesve përsa i përket garantimit efektiv të sigurisë së informacionit (SMSI) në proceset përpunuese;
- rol aktiv në zgjerimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore;
- programimi i masave në kuadër të zhvillimit të edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit në Tiranë më 2024;
- rol aktiv në kuadër të organizmave ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është pjesë si dhe me autoritetet homologe në të dy fushat e përgjegjësisë;

- aplikimi për përfitimin e projekteve nga programe të asistencës nga fondet IPA të BE dhe/ose donatorë të tjerë, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale.

Si autoritet i pavarur në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, do të forcojë rolin e saj të pavarur mbikëqyrës në të dy këto shtylla të rëndësishme. Kjo Zyrë ushtron edhe funksione të tjera në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, monitorimit të sektorëve me sensibilitet të veçantë apo që kanë të bëjnë me aspektet e integritetit dhe mirëqeverisjes, në bazë të kompetencave që i janë dhënë me ligje apo strategji të veçanta, të cilat do të detajohen në brendësi të këtij relacioni.

Hartimi i këtij Projekt-Buxheti (2024-2026), bazohet në analizën e performancës institucionale për vitin 2022 të Zyrës së Komisionerit, pritshmërive për vitin 2023, të parashikuara edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022”, detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe nivelit të plotësimit të indikatorëve, që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë në nivel kombëtar dhe detyrime të tjera për zbatim, të cilat burojnë nga legjislacione vendase por edhe nga detyrimet e legjislacionit të përafruar me aquiss komunitare, ku forcimi i rolit mbikëqyrës për zbatimin e tyre, nuk mund të realizohet pa forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare.

Buxheti real për të cilin ka nevojë Zyra e Komisionerit, janë paraqitur në Fazën Strategjike (politikat ekzistuese dhe të reja), por për arsye të detyrimeve ligjore, pasqyrat në këtë fazë janë plotësuar sipas formateve të Udhëzimeve të MFE për përgatitjen e PBA-së, por duke dërguar njëkohësisht edhe kërkesat shtesë sipas prioritetëve dhe kategorisë së shpenzimit. Konstatohet se në këtë fazë (*VKM nr. 436, datë 19.07.2023 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm (2024-2026)”*), nuk janë marrë në konsideratë në mënyrë absolute asnjë nga kërkesat e Zyrës së Komisionerit edhe pse të argumentuara teresisht por për më tepër as edhe garantimi i shpenzimeve të personelit (paga e sigurime) që vjen si rezultat i reformës në sistemin e pagave të personelit, që prej vitit 2023 bërë efektive. Mbi bazën e Vendimeve nr. 325 dhe 326, datë 31.05.2023 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka alokuar fondin shtesë, nga fondi i kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të personelit (për numrin faktik të punonjësve). As në VKM nr. 195, datë 05.04.2023, “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, dhe as V.K.M nr. 436, datë 19.07.2023, MFE nuk ka relatuar dhe as ka reflektuar financimin në paga e sigurime shoqërore për numrin efektiv të punonjësve sipas strukturës dhe Ligjit të buxhetit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”. Ndërkohë me Vendimin e Kuvendit nr.24/2023 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, numri i punonjësve është miratuar 60 vetë, për të cilën pritet gjatë këtij viti reflektimi i saj në ligjin e buxhetit, si numër i shtuar por në proporcion edhe me të gjitha shpenzimet (personeli/operative/kapitale).

MFE jo vetëm nuk ka respektuar/garantuar shpenzimet për paga & sigurime, por në cilësinë e institucionit përgjegjës të vlerësimit të kërkesave buxhetore të institucioneve, **nuk ka marrë fare në konsideratë asnjë prej kërkesave shtesë të paraqitura nga**

Zyra e Komisionerit, përfshirë këtu financimin e aktivitetit më të rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtës për informim që do të mbahet në vendin tonë: Organizimi i edicionit të 15-të të **Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)** në Tiranë 2024.

Zyra e Komisionerit është konsultuar me nivelet e buxhetimit të disa institucioneve të tjera të pavaruara, ku natyra e punës është e njëjtë ose e përafërt. Nga analiza e dokumentit të PBA-së, konstatohet se nivelet e shpërndarjes së buxheteve nuk janë në proporcion me veprimtarinë, funksionet e tyre dhe kërkesat e tyre. Ndaj do të sugjerohet të kryhej një analizë e mirëfilltë e kërkesave buxhetore për secilin institucion, duke alokuar fonde në mënyrë të drejtë dhe efektive.

Kërkesat buxhetore të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konsultohen me elementë të shoqërisë civile, gjatë raportimeve për plotësimin e masave dhe indikatorëve të parashikuara në strategjitë konkrete. Edhe pse të argumentuara drejt, vlerësuar edhe nga MFE gjatë analizës buxhetore të fazës së parë (Strategjike) mbi PBA 2024-2026, kërkesat shtesë për mbështetje financiare, kryesisht në shpenzimet paga/operative dhe ato për investime, nuk janë marrë parasysht. Ritheksojmë se mungesa e alokimit të kërkesave shtesë do të kufizojë veprimtarinë institucionale, duke ndikuar negativisht në të gjithë aspektin funksional dhe ekzistencial. Paraqitja e dokumentit të PBA 2024-2026 në këtë fazë vijon të mbajë të njëjtin qëndrim lidhur me mospërfshirjen dhe plotësimin e PBA-së në sistemin AFMIS deri në marrjen e masave për përpunimin e të dhënave të përdoruesve gjatë autentifikimit në sistemin AFMIS, sipas rekomandimeve të dhëna nga KDIMDP. Në funksion të zbatimit të rekomandimit të Zyrës së Komisionerit lidhur me këtë sistem, do të shihet edhe mundësia e paraqitjes së PBA 2024-2026 me formatet e gjeneruara nga sistemi AFMIS. Gjithsesi është ruajtur i njëjti format zyrtar i paraqitjes, duke mos u bërë pengesë për vlerësim të kërkesave buxhetore dhe bërjes efektive të tyre.

Zyra e Komisionerit ka arritur nëpërmjet burimeve të saj ekzistuese të realizojë një pjesë të objektivëve dhe indikatorëve të parashikuara në vite, por mungesa e fondeve të dedikuara, do të kushtëzojë moszbatimin dhe mosplotësimin e tyre, në vijim.

Përsa më sipër dhe në zbatim të udhëzimeve për hartimin dhe finalizimin e dokumentit të PBA 2024-2026, Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) pas konsultimeve, vendosi të paraqesë kërkesat sipas strukturës dhe formateve të kërkuar.

Në formatet e plotësuara respektive, janë përcaktuar objektivët kryesorë institucionale si dhe treguesit e performancës në nivel qëllimi, por dhe në nivel objektivësh, për secilën nga fushat e përgjegjësisë, të rishikuara, referuar analizës së kërkesave buxhetore, të paraqitura në fazën strategjike.

a. *Formati nr.1 “Misioni i njësisë së qeverisjes qendrore/Misioni i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:*

Mbrojtja dhe garantimi i dy të drejtave themelore, e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale.

b. Formati nr.2. *“Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2024-2026 për politikat ekzistuese sipas tavanëve”.*

Në këtë fazë, edhe pse në aspektin teknik, kemi paraqitur kërkesat buxhetore sipas politikave ekzistuese brenda tavanëve indikativë të Programit me kosto për produkt dhe sipas artikujve ekonomikë, por ndërkohë riprezantojmë edhe kërkesa shtesë. Edhe pse Udhëzimi i përgatitjes së buxhetit nuk e parashikon në këtë fazë paraqitjen e kërkesave shtesë, Zyra e Komisionerit e konsideron tejet të domosdoshme riparaqitjen e kërkesave për financimin shtesë për politikat ekzistuese (mangësi financimi të strukturës së miratuar si dhe shpenzimet operative), por edhe për prioritetet të lidhura me politikat e reja, si detyrime për tu financuar. Argumentet janë detajuar në fazën strategjike, por edhe të shtuara në këtë fazë, për shkaqe të detajuara në vijimësi të këtij relacioni (shtim i kompetencave të reja dhe pritshmërive të ndryshimeve legislative, të cilat kanë sjellë rritje pjesërisht të kapaciteteve në burime njerëzore, por të pambuluar me shpenzime financiare dhe komunikimet periodike me MFE).

b.1 Formatin 2.1 *“Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2024-2026 për politikat ekzistuese, sipas nevojave, përtej tavanëve”,* si detyrime për tu financuar

b.2 Formatin 2.2 *“Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2024-2026 përmbledhëse e kërkesave për financim për politikat ekzistuese e të reja, sipas nevojave, përtej tavanëve, për secilin grup shpenzimi”,* si detyrime për tu financuar

c. Formatin 3 *“Formati Standard i përllogaritjes së plotë të kostos së Politikave e reja 2024-2026, sipas nevojave, përtej tavanëve”,* si detyrime për tu financuar

d. Shtojca I-A – pasqyrat shtesë për buxhetin 2024-2026

e. Formatin 4 *“Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2024-2026 për investimet në vazhdim dhe ato të reja përtej tavanëve, përtej tavanëve sipas prioritetëve”,* si detyrime për tu financuar

f. Aneksat - Formular të Propozimit të Projekteve të Investimeve (FPPI) për disa projekte shtesë.

Në këto formate janë parashikuar objektivet kryesorë institucionale si dhe treguesit e performancës, sipas trendit.

NË LIDHJE ME KËRKESAT SHITESË PËRTEJ TAVANEVE (POLITIKA EKZISTUESE)

Me Ligjin e Buxhetit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, numri i miratuar i punonjësve është 52, por i pambuluar plotësisht me fondin e nevojshëm të shpenzimeve të personelit për vitin 2023. **Mungesa e financimit rezulton edhe në tavanet e PBA 2024-2026.**

Prej vitit 2016 e në vijim, Zyra e Komisionerit ka bërë prezent mungesën e kapaciteteve, e cila është evidentuar si problematikë në Raportet e Shtetit të BE-së çdo vit, ku gjatë 5

viteve të fundit kërkohet mbështetja e Zyrës së Komisionerit me rritje kapacitetesh me qëllim garantimin e dy të drejtave kushtetuese që ky institucion mbikëqyr si dhe përgjigjen në mënyrë efektive ndaj sfidave që paraqet përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

Për arsye të miratimit të një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, janë shtuar funksionet dhe kompetencat e Zyrës së Komisionerit, të cilat priten të shtohen edhe me miratimin e disa akteve të tjera ligjore në fushën e përgjegjësisë së Zyrës sonë brenda vitit 2023.

Për këtë arsye është miratuar me Vendimin nr. 24/2023 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, struktura **prej 60 punonjësish** e cila i shtrin efektet e saj menjëherë brenda vitit 2023. Struktura është e pashoqëruar me efektet financiare (paga & sigurime & shpenzime operative dhe investime) për vitin aktual 2023 por në proporcion edhe për tre vitet e PBA 2024-2026.

Në zbatim të udhëzimit në këtë format janë pasqyruar kostot e produktit/eve në vlerën e plotë reale përtej tavaneve indikative. Gjithashtu, janë plotësuar të gjithë elementët e nevojshëm të paraqitjes së kërkesave buxhetore sipas nevojave, ku evidentohet rritja e numrit të punonjësve e cila shkon paralelisht me rritjen e çdo shpenzimi në nivel artikulli, si për shpenzimet korrente dhe ato kapitale administrative.

Përsa më sipër, Zyra e Komisionerit paraqet kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese për 60 punonjës.

- 1- Kërkohet miratimi i numrit të punonjësve sipas Vendimit nr. 24/2023 të Kuvendit të Shqipërisë (60 vetë) si dhe shtesë fondesh, në proporcion me këtë numër në **Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore”**, duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet ligjore në sistemin e reformimit të pagave, VKM nr. 325 dhe 326, datë 31.05.2023.

Vlera e shtuar kap shumën 60.500 (në mijë) lekë, i përllogaritur për çdo vit 2024-2026, detajuar në formatet respektive, **për numrin e punonjësve 60.**

- Shpenzimet e parashikuara në tavanet perfundimtare si të fazës së parë dhe të dytë (VKM përkatëse) i referohen numrit të punonjësve në vitin 2022, prej 49 punonjësish me pagat e vjetra, duke mos marrë në konsideratë numrin aktual të punonjësve miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe më tej Vendimit nr. 24/2023 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ku është miratuar struktura me një numër prej 60 punonjësish. Bashkëlidhur sikundër kërkoni edhe në analizën buxhetore të PBA 2024-2026, gjeni përllogaritjet për shpenzimet e personelit (fondi page/600 dhe sigurime shoqërore e shëndetësore/601), për 52 punonjës, me pagat përpara rritjes apo të rritura. Gjithashtu gjeni përllogaritjen e pagave dhe sigurimeve për 60 punonjës me pagat përpara rritjes apo të rritura. Në vlerësimin tuaj mbi mënyrën e mbulimit financiar për garantimin në kohë të pagave dhe sigurimeve shoqërore për çdo punonjës për zbatimin e Vendimit nr. 24/2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2- Fondet për mbulimin e punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë) janë në shumën **2.400 (në mijë) lekë**, të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga ana juaj, pasi kërkesat do të vijojnë edhe për vitin 2024-2026 (5 punonjës), me argumentimin e njëjtë si në vitin 2023, të cilat do të kenë burim financimi **Artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”**. Në analizën buxhetore jeni shprehur (sikundër citohet edhe ne VKM respektive) që kërkesa bëhet vetëm kur ka fonde financiare. Po në rastet kur fondet janë tepër të cunguara dhe për më tepër më të ulta nga një vit më parë ??? Po kur domosdoshmëria e punonjësve është evidente ?? . Lutem vlerësoni kërkesat e institucionit për financim jo vetëm për punonjës por edhe për ushtrimin e aktivitetit të institucioneve të pavarura, duke mos cënuar në këtë mënyrë pavarësinë e tyre .

3- **Artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”**, kërkohet dyfishim i tavaneve të miratuara, në shumën rreth **20.000 (në mijë) lekë** për vitin 2024,

-si kosto administrative për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës, si pasojë e detyrimeve që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit për plotësimin e shumë indikatorëve të përcaktuara në disa strategji kombëtare të miratura (të **pambuluara nga buxheti**) dhe legjislacionit të ri në të dy fushat e përgjegjësisë (mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim) e përlllogaritur në mënyrë tepër modeste në vitin 2024, në vlerën rreth 5.000 (në mijë) lekë. Në funksion të realizimit në vitin 2024, do të rishikojmë kostot në vitet më pas sigurisht në trendin rritës. Më gjerësisht :

Disa nga strategji kombëtare (me efektet e tyre financiare) referuar edhe analizës së kërkesave buxhetore 2024-2026 mbi detajimin në nivel qëllimi dhe objektivi strategjik për çka i janë ngarkuar Zyrës së Komisionerit si dhe kostot e planifikuara nga plan veprimet, ku më poshtë përmendim:

1. Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit IV “Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës”.

Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike

4.1.1.ë Realizimi i materialeve të hartuara, publikuara dhe të shpërndara te qytetarët, institucionet dhe në faqen zyrtare të KDIMDHP/emisione TV/ botim (revistë periodike) 6-mujore (**Kosto Indikative: 23, 792**)

Objektivi specifik 4.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik.

4.2.1.k Zhvillimi i trajnimeve me autoritetet publike dhe/ose kontrollues/përpunues në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale **(Kosto Indikative: 1, 920)**

Objektivi specifik 4.5: Nxitja e aktivizimit të publikut përmes informimit mbi përgjegjësitë e institucioneve dhe mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje

4.5.1 Ditët e Hapura pranë Bashkive/forume me qytetarë **(Kosto indikative: Totali 26,962, Buxheti i shteti 20.125, Hendek 2.896)**

4.5.1.c Zhvillimi i Ditëve të Hapura për të drejtën e informimit **(Kosto Indikative: Projekti: 1 800, Buxheti i shtetit: 200)**

2. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (AKDF) dhe Plani i Veprimit 2021-2026 ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivëve të poshtë cituar

Qëllimi i Politikës II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme.

Objektivi specifik II.2: Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve.

II.2.1. Përmirësimi i kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës.

II.2.1.dh Miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i përafëruar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR).

(Buxheti planifikuar & Donatore: Programi IPA 2017, Shifra totale e projektit : 400 000 euro, Vetëm për hartimin e projektligjit kosto është: 71.811.94 EUR, Buxheti i shtetit: 5 398 560 lekë).

Qëllimi i Politikës IV: Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

Objektivi specifik IV.1: Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

IV.1.2 Nxënja dhe kreativiteti në mjedisin digjital

IV.1.2.b Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet, privatësinë, ndarjen e informacionit dhe antiviruseve. **(Kosto Administrative shtesë buxheti)**

3. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur (SNDM) dhe Plani i Veprimit 2022-2026 Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit 1.1 “Informim/edukim/ndërgjegjësim në qarqet e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë”. **Aktiviteti 1.1.10.1** “Fushatë kombëtare ndërgjegjësuere me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrativ)”.

Masa: 1.1.10 Fushata ndërgjegjësuese kombëtare për promovimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

1.1.10.1 Fushatë kombëtare ndërgjegjësuese me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin së të dhënave personale, në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrative). (**Kosto Administrative shtesë**)

4. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 (SKZHI) ku objektivet strategjike ku është përfshirë Zyra e Komisionerit janë

- Zbatimi i normave rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave personale në epokën e digjitalizimit të shpejtë Vlera Totale: 99 295 000 lekë përmes:

Indikatorët:

- Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale i përafëruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë; **vlera e synuar** për vitin 2022 është 2 000 000 lekë, për vitin 2023 është 500 000 lekë, për vitin 2024 është 500 000 lekë)
- Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit, me qëllim përmbushjen e detyrave shtesë të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale; (**vlera e synuar** për vitin 2022 është 32 460 000 lekë, për vitin 2023 është 32 860 000 lekë, për vitin 2024 është 30 975 000 lekë)
- Promovimi i një dialogu me Nëpunësit e Mbrojtjes së të Dhënave të sektorit publik dhe privat (**Kosto Administrative të shtuara**);
- **Forcimi i komunikimit proaktiv i autoriteteve publike duke synuar ndërtimin e një kulture transparence (Kosto administrative të shtuara) përmes:**

Indikatorët:

- Monitorimi dhe mbikëqyrja e autoriteteve publike të kategorive të ndryshme për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës dhe të Regjistratit të kërkesave dhe përgjigjeve, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë tyre (**Kosto e shtuar administrative**).
- Mbështetje për autoritetet publike në qartësimin e çështjeve me interes publik dhe rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, sidomos, përdorimin e konceptit të konfidencialitetit (**Kosto e shtuar administrative**)
- Forcimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit nëpërmjet trajnimeve periodike dhe mbështetje teknike për institucionet (**Kosto e shtuar administrative**)
- **Garantimi i të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale përmes rritjes së ndërgjegjësimit për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve me fokus brezin**

e ri si dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore nga autoritetet publike dhe kontrolluesit publikë/privatë. (Kosto administrative)

Indikatorët:

- Bashkëpunimin me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimit në zbatimin e tij. **(Kosto Administrative shitesë)**
- Bashkëpunimin me autoritetet / kontrolluesit publik dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për njohjen e legjislacionit. **(Kosto Administrative shitesë)**
- Bashkëpunime dhe trajnime me Institucione të Arsimit të Lartë në qytete të ndryshme të vendit. **(Kosto Administrative shitesë)**

- 4- Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën publike 2023-2030 ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit A.1 “Rritja e transparencës së autoriteteve publike duke i bërë informacionet lehtësisht të aksesueshme për publikun”, **pa kosto administrative shitesë**

Vizioni : Mbrojtja dhe promovimi i së drejtës për informim si një e drejtë themelore e njeriut dhe një gur themeli i transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë në një shoqëri demokratike. Mbështetje për një administratë publike të hapur dhe të përgjegjshme që respekton dhe mbështet të drejtën e individëve për të aksesuar informacionin publik. Kjo siguron që qytetarët mund të marrin vendime të informuara, të marrin pjesë në debate publike dhe të mbajnë administratën publike përgjegjëse për veprimet e saj.

Aktivitetet:

1. Vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike.
 - 1.1 Plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e administratës qendrore
 - 1.2 Plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e njësive të vetëqeverisjes vendore
2. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore janë në dijeni dhe të qartë për ndryshime ligjore ne Ligjin “Për të Drejtën e Informimit”
 - 2.1 Miratimi i ndryshimit të ligjit për të drejtën e Informimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
 - 2.2 Trajnime të dedikuara për koordinatorët e të drejtës për informim, në bashkëpunim me ASPA
 - 2.3 Trajnime të dedikuara për TND

- 5- Strategjia Antikorrupsion (SNKK) 2023-2030 ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit A.1 “Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion”

Për sa i përket planit të veprimit 2023-2025 dhe Kostimit të tij, Zyra e Komisionerit parashikohet të jetë institucion përgjegjës për masën A.2.5 “Monitorim periodik të transparencës së autoriteteve publike” dhe nënmasat e saj:

A.2.5.a 1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së institucioneve qendrore

A.2.5.b 1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në lidhje me këtë masë dhe dy nënmasat përkatëse, Zyra e Komisionerit shprehet dakord. Për sa i përket kostimit të kësaj mase Zyra e Komisionerit parashikon një **Kosto indikative** 2.225.000 Lekë në vit, e cila mbulohet nga buxheti i shtetit me kodin buxhetor 1089001.

Gjithashtu në planin e veprimit 2023 - 2025 është parashikuar që Zyra e Komisionerit të jetë institucion kontribues për masën A.1.2 “Hartimi i modelit të raportit vjetor të institucioneve (nivel qendror, vendor) – 2024 (MD+KDI)” dhe nën masën e saj:

A.1.2.a Tryeza diskutimi me përfaqësues të institucioneve për hartimin e modelit të raporteve vjetore;

Edhe në lidhje me këtë masë, Zyra e Komisionerit kërkon kosto shtesë administrative

Kërkesat shtesë për shpenzimet operative për vitet 2024-2026, sikundër kemi bërë me dije edhe në fazën e parë (strategjike) listohen

- si rezultat i miratimit të ndryshimeve të reja ligjore, ku do të ndërrmerret një fushatë e gjerë ndërgjegjësuere në të gjithë territorin e vendit me target grupe sektoriale të kontrolluesve dhe qytetarëve, të cilët do të njihen gjerësisht me detyrimet e risitë e reja ligjore, por ndërkohe edhe të drejtat e tyre, gjatë zbatimit të këtyre akteve, e përllogaritur në vlerën rreth 10.000 (në mijë) lekë. Më gjerësisht

Komisioni Evropian në raportin e shqyrtimit analitik (*screening report*) për Grupin e Parë Themelorët për nënkapitullin e të Drejtave Themelore, ka dërguar gjetjet dhe vlerësimet e saj, duke kërkuar adresimin me masa konkrete të tyre. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale iu përcjell masat, për sa i takon pjesës së “Mbrojtjes së të dhënave personale” dhe 3 pikave në pjesën “Liria e shprehjes, duke përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medias”, listuar më poshtë, të cilat padiskutim kërkojnë kosto shtesë. Kosto e kërkuar më sipër është e kufizuar për vitet 2024-2026, por në mënyrë të panegociueshme do të jetë më e lartë, në funksion dhe vartësi të ecurisë së realizimit gjatë vitit 2024.

Lidhur me pjesën “Mbrojtja e të dhënave personale”, masa konkrete që parashikon të realizojë Zyra e Komisionerit, dërguar zyrtarisht edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr prot 1314/1, datë 21.08.2023, do të jenë:

- Harmonizimi i “Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” me “Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave” dhe “Direktivën për Zbatimin e Ligjit”, brenda vitit 2023.

- Miratimi i 13 akteve nënligjore në bazë të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, buxhetore dhe administrative në funksion të kompetencave dhe detyrave të reja që rrjedhin nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale brenda vitit 2025 dhe zbatimi i Vendimit nr. 24/2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- Promovimi i qasjes së re të kontrolluesve dhe përpunuesve në procesin e përpunimit të të dhënave personale me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit, vijon me intensitet dhe parashikohet që ky proces intensiv të zgjasë deri në 2 vite pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri.
- Organizimi i trajnimeve periodike me qëllim rritjen e aftësive të kontrolluesve dhe përpunuesve, mbi përpunimin me përgjegjësi të të dhënave personale të qytetarëve, gjatë viteve 2024 – 2026.
- Rritja e ndërgjegjësimit për legjislacionin e ri, përmes programeve arsimore të dedikuara për të gjitha grupmoshat, (veçanërisht grupet më vulnerabël të ekspozuara ndaj rrezikut të cënimit të privatësisë, si fëmijët dhe të rinjtë), brenda vitit 2025.
- Forcimi i njohurive akademike në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke rritur numrin e ekspertëve/profesionistëve përmes bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, Shkollën e Magjistraturës dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, brenda vitit 2025.
- Forcimi dhe konsolidimi i “Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale” në sektorin publik dhe privat si dhe nxitja e dialogut me to, brenda vitit 2025.
- Kryerja e hetimeve kryesisht dhe ndjekja e rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrolluesit dhe përpunuesit, bazuar në objektivat dhe afatet e përcaktuara në Strategjinë Institucionale 2022-2025 dhe programin vjetor të punës së KDIMDP-së, në vazhdimësi.
- Identifikimi dhe mbikëqyrja e sigurisë teknike në kontrolluesit publik dhe privat, mbi ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe besueshmërisë së sigurisë së informacionit, veçanërisht për SMSI, në procesin e përpunimit të të dhënave personale, në vazhdimësi.
- Kryerja e hetimeve administrative në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, (Udhëzimi nr.46, datë 28.03.2017 dhe Udhëzimi i përbashkët me Ministrinë e Brendshme nr.1181, datë 30.10.2017), gjatë viteve 2023 – 2025.
- Aplikim për projekte të mundshme që synojnë të mbështesin zbatimin efikas të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, brenda vitit 2025.

Për sa i përket gjetjeve që lidhen me të drejtën për informim në pjesën “Liria e shprehjes, duke përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medias” propozojmë masat e mëposhtme:

- Miratimi i projektligjit ““Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, brenda vitit 2023.
- Parashikime konkrete në ligjin e ri, të dispozitave që synojnë vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë për çdo nëpunës publik përfshirë dhe titullarin, në rastet e mos zbatimit të vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, brenda vitit 2023.
- Parashikime konkrete në ligjin e ri, të dispozitave që synojnë shtimin e kompetencës së Zyrës së Komisionerit për të zhvilluar trajnime për çështje të së drejtës për informim dhe detyrimi i vetë autoriteteve publike për të zhvilluar trajnime për nëpunësit, brenda vitit 2023.
- Veprimtari ndërgjegjësuere dhe trajnuese me autoritetet publike lidhur me respektimin e afateve ligjore, në kthimin e përgjigjeve të kërkesave për informacion të gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, në vazhdimësi.
- Trajnime (në kuadër dhe të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike, Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut) me koordinatoret për të drejtën e informimit, nëpunësit publik përfshirë dhe Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues, në vazhdimësi.

Nuk mund të realizohen këto masa dhe jo vetëm me buxhetin e parashikuar nga MFE për Zyrën e Komisionerit, ku duke mos arsyetuar dhe vlerësuar asnjë kërkesë shtesë edhe pse të mirëargumentuara dhe tepër të detajuara, për vitin 2023 vlera e shpenzimeve operative renë zbritje nga një vit më parë, ku aktivitetet dhe veprimtaria e Zyrës së Komisionerit si rezultat i kompetencave dhe përgjegjësi të ngarkuara ligjërisht, është shtuar së tepërmi.

- si kosto e mirëmbajtjes së databazave shtetërore, ku Zyra e Komisionerit është administrator apo dhe programeve/softeve aktuale të implemetuara këtë vit buxhetor por dhe sistemeve të pritshme për tu implementuar, e përlllogaritur në vlerën rreth 5.000 (në mijë) lekë për vitin e parë 2024 si dhe me një trend proporcional për secilin vit **buxhetor 2025-2026**, detajuar në formatet respektive.

Lidhur me këto shpenzime të kërkuara nga institucioni ynë por edhe nga JU, gjatë analizës së kërkesave buxhetore 2024-2026 më mirë të argumentuara apo më të detajuara evidentojmë se Zyra e Komisionerit administron 2 (dy) databazat më të rëndësishme në nivel kombëtar (databaza shtetërore të regjistruara) në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Ju informojmë se Zyra e Komisionerit mbledh informacion dhe përpunon të dhëna, në bazë të detyrimeve që i burojnë nga kuadri ligjor, që mbështet ushtrimin e veprimtarisë në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, vendimit nr. 145/2018 të

Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”. Zyra e Komisionerit është ngarkuar me administrimin e kësaj databaze, e cila ka tre kategori përdoruesish: qytetarët (për ushtrimin e të drejtës së kërkesës për marrjen e informacionit publik dhe të ankesës pranë Zyrës së Komisionerit për mos marrje apo marrje të pjesshme të informacionit); koordinatorët e të drejtës për informim (për trajtimin e kërkesave/kthimin e përgjigjeve) dhe Zyra e Komisionerit për trajtimin e ankesave. *Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit*” (REKPDI), i integruar në portalin pyetshtetin.al, është një instrument elektronik që mundëson në mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë marrjen e informacionit me karakter publik nga qytetarët. Data baza dhe portali kanë nevojë të mirëmbahen teknikisht çdo vit me kosto financiare.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar është ndërtuar dhe miratuar me Vendimin nr. 144, date 13.03.2018” Per krijimin e baze se te dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrollues”, i cili është aktiv Zyra e Komisionerit është ngarkuar me administrimin e kësaj databaze, e cila ka si qëllim pasqyrimin e kontrolluesve dhe aktiviteteve përpunuese në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përdorues të kësaj databaze janë dy kategori: kontrollues publik/privat (popullimin e të dhënave elektronikisht për kryerjen e procesit të “Njoftimit”) dhe Zyra e Komisionerit (popullimin e të dhënave në rastin e plotësimit të “Njoftimit” shkresërisht/manualisht; çdo ndryshim të deklaruar nga kontrolluesit; nxjerrje raportesh). Data baza ka nevojë të mirëmbahet teknikisht çdo vit me kosto financiare.

Ndërkohë nëpërmjet prokurimit elektronik me fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2023, është ndërtuar dhe aktualisht është në funksion “Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave me vleren 5.400 (në mijë lekë), i cili kërkon detyrimisht edhe mirëmbajtje periodike në vlerën 600 (në mijë) lekë çdo vit. Ky shërbim është kontraktuar për tre vite në vijim dhe për këtë kërkohej mbulimi financiar. Sistemi konsistoi në automatizimin e proceseve të punës me synim administrimin efektiv të dokumentacionit brenda Institucionit. Nëpërmjet implementimit të një programi për automatizimin e proceseve të punës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale synon të reduktojë dhe menaxhojë kohën e shqyrtimit të dokumentacionit brenda afateve kohore dhe të rrisë cilësinë në ofrimin e shërbimeve ndaj palëve të treta.

Zhvillimi i infrastrukturës si prioritet të listuara gjatë kërkesave buxhetore shtesë 2024-2026 si në politikat egzistuese apo edhe ato të reja, ne refernce edhe më poshtë në postet e kërkesave shtesë për shpenzimet kapitale si dhe ne fishat e plotësuara për investimet FPPI sistemet/regjistrat/dixhitalizimet e praktikave të punës kerkojne kosto shtesë për mirëmbajtjen periodike të tyre, për të shmangur çdo rrezik që cënon jo vetëm funksionalitetin e tyre por dhe shmang çdo rrezik tjetër teknik si humbje të dhënash, shkatërrime, transferime apo keqpërdorime etj etj.

- 1- Artikulli 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, e cila parashikohet të jetë me një shtesë prej 22.000 (në mijë) lekë mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive.**

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) shihet si një mjet i cili ndryshon jetën e përditshme, transformon organizimin e punës, ndryshon tregjet ekzistuese duke krijuar mundësi dhe modele të reja biznesi, pjesëmarrjeje, bashkëpunimi e ndërveprimi me Administratën Publike, një qeverisje të hapur dhe transparente.

Përdorimi i mjeteve TIK synon lehtësimin e qasjes ndaj informacionit, përmirësimin e proceseve administrative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në një numër fushash të veprimitarisë së institucionit. Prioritet i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike, investime të cilat renditen sipas prioritarizimit për sa më poshtë:

- **“Blerje pajisje TIK për domein controller të IDI dhe mirëmbajtje”**, parashikohet të jetë në shumën **13.000 (në mijë) lekë, për vitin 2024**, ndërsa do të mirëmbahet infrastruktura çdo vit me fondet e shpenzimeve operative (ku fondet janë kërkuar në kërkesat shtesë për shpenzimet operative).

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve ndaj përdoruesve dhe proceseve të punës. Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar objektivat si më poshtë:

- Upgrade i infrastrukturës me Servera të rinj.
- Upgrade i infrastrukturës me Storage për backup.
- Upgrade i infrastrukturës me Sistem për backup.
- Upgrade i infrastrukturës me teknologji të reja për qëllime arkivimi.
- Rinovimi i licensave dhe mirembajtje për Mdaemon Email 60 users.
- Upgrade i infrastrukturës së rrjetit me pajisje të reja si server, switch etj.
- Përmirësim i politikave të menaxhimit dhe sigurisë së informacionit.

Blerja e pajisjeve të kërkuara ka si qëllim përmbushjen e këkesave duke përmirësuar infrastrukturën aktuale me anë të këtyre pajisjeve kompjuterike/TIK. Kjo procedurë do të mundësojë mbarëvajtjen e punës për punonjësit e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu do të garantojë sigurinë e infrastrukturës network në institucion duke integruar modulet e menaxhimit si: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve si dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet teknologjike.

